



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 5 JANAR 2021**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 5. JANUAR 2021. GODINE**

**JANAR - JANUAR
2021**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë për dërgimin e Kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit.

Dnevni red

2. Razmatranje Predlog-odluke Vlade Republike Kosovo za slanje kontingenta Kosovskih snaga bezbednosti van zemlje.

Mbledhjen e drejtoi kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani.

KRYETARJA: Të nderuar deputetë,

Në sallë janë 80 deputetë, i hap punimet e seancës së jashtëzakonshme me kërkesë të kryeministrit të Kosovës me këtë rend dite:

1. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për dërgimin e kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit

Propozim-vendimi i Qeverisë nuk u është shpërndarë deputetëve tri ditë pune para shqyrtimit në seancë plenare, andaj për shqyrtimin e tij duhet të bëhet shmangia nga afati paraparë në nenin 15, paragrafi 7 të Rregullores së Kuvendit.

Në qoftë se grupet parlamentare janë dakord, po shkojmë drejt me proces të votimit. Siç e dini, kërkohet që 2/3 e deputetëve të pranishëm të votojnë pro shmangies nga procedurat, në mënyrë që të mund ta shqyrtojmë këtë pikë të rendit të ditës.

I lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për shmangie nga afati i paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

Kush është për? A ka kundër? A ka abstenime? Nuk ka!

Me 84 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi vendosi që shqyrtimi i propozimit për dërgimin e kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit të bëhet me shmangie nga afati i paraparë në nenin 15, paragrafi 7 të Rregullores së Kuvendit.

1. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për dërgimin e kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit

Të nderuar deputetë,

Qeveria ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim në Kuvend propozim-vendimin që e përmenda më herët. Komisioni FunkSIONAL për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes e ka shqyrtuar këtë propozim-vendim dhe i ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë.

Ftoj fillimisht kryeministrin e Kosovës ose ministrin e Mbrojtjes, cilido që dëshiron të flasë në emër të Qeverisë, kryeministri, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë propozim-vendimin.

KRYEMINISTRI AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetare e Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar qytetarë,

Qeveria e Republikës së Kosovës i ka ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale dhe ligjore për dërgimin e kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në kuadër të Gardës Kombëtare të Ajovës në misionin paqeruajtës, me qëllim të sigurimit të stabilitetit rajonal në regionin e Komandës qendrore amerikane.

Qeveria e Republikës së Kosovës sipas kërkesave ligjore vendimin e saj e ka adresuar në Kuvendin e Kosovës për shqyrtim dhe miratim, si organi më i lartë që autorizon dërgimin e trupave të FSK-së me misione paqeruajtëse jashtë vendit.

Përparimi i vazhdueshëm në aspektin operacional dhe profesional i Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe përkushtimi i jashtëzakonshëm i vajzave dhe djemve tanë ka bërë që FSK-ja ta fitojë besimin e partnerit tonë strategjik, kryesori, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për të qenë në krah të forcave paqeruajtëse amerikane në misione ndërkombëtare paqeruajtëse.

Kjo mundësi që na jepet konfirmon besimin e partnerëve tanë strategjikë për rolin e Kosovës jo vetëm me sigurinë rajonale, por edhe me sigurinë ndërkombëtare.

Vendimi i Qeverisë së Kosovës për ta dërguar FSK-në në misione paqeruajtëse jashtë vendit tregon se Kosova mbetet e përkushtuar ta rrisë bashkëpunimin me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me vendet e tjera aleate.

Këtë mision duhet ta konceptojmë jo vetëm si një detyrë në kuadër të marrëdhënieve tona ndërkombëtare, por si një konfirmim të rrugëtimit tonë drejt integritetit euro-atlantik. Përtej simbolikës që është tepër domethënëse për secilin prej nesh dhe për secilin qytetar të Republikës, misioni i parë i pjesëtarëve të FSK-së na bënë krenarë edhe për faktin se ai do të realizohet në bashkëpunim të plotë me Gardën Kombëtare të Ajovës, e cila ka dhënë ndihmesë të çmueshme në profesionalizimin e FSK-së.

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Të nderuar qytetarë,

Unë ndjehem i privilegjuar që në mandatin e kësaj qeverie, Republika e Kosovës edhe në fushën e sigurisë po bëhet pjesë e familjes së madhe të kombeve të lira. Kjo nënkupton se ne, si çdo komb tjetër sovran në botë, po marrim pjesën tonë të përgjegjësisë për paqen globale, mirëqenien dhe sigurinë e përgjithshme. Sot së bashku ju ftoj ta pohojmë njëzëshëm para miqve dhe botës mbarë se ne jemi të ndërgjegjshëm dhe besimplotë jo vetëm për mundësitë, por edhe për përgjegjësitë që na takojnë.

Republika e Kosovës është e përkushtuar për paqe dhe bashkëpunim ndërmjet shteteve sovrane, ndërmjet popujve liridashës kudo në botë. Duke votuar këtë propozim të Qeverisë së Republikës

së Kosovës, ju do ta shkruani një faqe të re dhe jashtëzakonisht të rëndësishme në udhën e afirmimit dhe të forcimit të rolit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës. Ju sonte do ta bëni realitet një ëndërr të kamotshme të shumë brezave. Ju sonte do ta bëni realitet FSK-në në misionet paqeruajtëse ndërkombëtare.

Populli i Kosovës, si pak popuj në botë e kupton rëndësinë e misionit paqeruajtës, e kemi provuar këtë para dy dekadave. Me këtë vendim sonte vendoset gurthemeli i radhës në rrugën tonë të integritetit euro-atlantik, të shtetit të Kosovës, në fushën e sigurisë në veçanti. Gurthemeli apo hapi i parë ka qenë vetë themelimi i Trupave Mbrojtëse të Kosovës pas luftës, të mbikëqyrur dhe të pranuar nga miqtë tanë ndërkombëtarë.

Hap tjetër ka qenë transformimi i Trupave Mbrojtëse të Kosovës në Forcë të Sigurisë së Kosovës, më tutje hap i madh ka qenë fillimi i planit të transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës drejt ushtrisë së rregullt, të cilën që jemi duke punuar çdo ditë që ta bëjmë realitet, duke e ndjekur me përpikëri planin e transformimit të FSK-së. Ndërkaq sot, me këtë vendim, ne renditemi krahas partnerëve tanë për të siguruar paqen në botë.

Unë falënderoj të gjitha grupet parlamentare, pa përjashtim, për mbështetjen që të jeni pjesë e kësaj seance dhe pres që edhe në votim do të jemi plotësisht të unifikuar.

Zoti e bekoftë miqësinë tonë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Zoti i bekoftë djemtë dhe vajzat e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARJA: Ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Në rregull, edhe ministri i Mbrojtjes mund ta marrë fjalën.

MINISTRI ANTON ÇUNI: E nderuar kryetare e Kuvendit të Republikës së Kosovës,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Ministria e Mbrojtjes, si dikaster përgjegjës qeveritar për mbrojtjen dhe sigurinë, sipas kërkesës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të adresuar përmes Ambasadës Amerikane në Prishtinë, lidhur me bashkëzbatimin në misionet për ofrimin e mbështetjes për stabilitet rajonal dhe operacione paqeruajtëse, ka konsideruar kërkesën dhe të njëjtës i është përgjigjur pozitivisht.

Në këtë kuadër Ministria e Mbrojtjes ka bashkërenduar veprimet edhe me institucione të tjera përmes rrugëve institucionale dhe diplomatike, por edhe i ka ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale për të realizuar kërkesat ligjore sa i përket bashkëzbatimit të pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës në kuadër të Gardës Kombëtare të shtetit të Ajovës.

Kosova tashmë ka një traditë bashkëpunimi me shtetin e Ajovës në shumë fusha. Prandaj, mundësia që FSK-ja t'i bashkohet Gardës Kombëtare në misione paqeruajtëse ndërkombëtare, është një mundësi unike jo vetëm për FSK-në, por edhe për Kosovës, për të fuqizuar subjektivitetin e saj ndërkombëtar dhe për të promovuar atë si një faktor me rëndësi edhe në paqen dhe sigurinë botërore.

Përkushtimi, integriteti dhe profesionalizmi i Forcës së Sigurisë së Kosovës po vlerësohen edhe në aspektin ndërkombëtar. FSK-ja jo vetëm që po vlerësohet me nota më të larta brenda Kosovës nga qytetarët të saj, ku për të nëntën herë është shpallur institucioni me besueshmërinë më të lartë, por të njëjtin vlerësim e kanë reflektuar edhe te partneri ynë strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që përfaqësojnë më së mirë vlerat më të larta demokratike.

Prandaj, është një momentum shumë i veçantë për Kosovën që përveç një mundësie historike, ku Forca e Sigurisë së Kosovës radhitet përkrah partnerëve strategjikë për të kontribuar në paqe dhe siguri në nivelin ndërkombëtar, njëkohësisht është një reflektim që të shohim prapa dhe të shprehim falënderimin dhe mirënjohjen shumë të lartë për mbështetjen e pakursyer për të gjithë partnerët tanë, të cilët arritën në Kosovë 20 vjet përpara, me të njëjtën mision për të vendosur dhe ruajtur paqen dhe sigurinë në Kosovë.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbesin partneri ynë kryesor, të cilët në vazhdimësi kanë kontribuar dhe vazhdojnë të kontribuojnë në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe operacionale të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës. Partneriteti ynë strategjik dhe mbështetja e vazhdueshme nga shteti i Ajovës është i një rëndësie të veçantë për zhvillimin e kapaciteteve të FSK-së. Prandaj, mundësia për të kontribuar në kuadër të Gardës Kombëtare të Ajovës, është njëkohësisht një mundësi, por edhe detyrim për të dhënë kontributin tonë në misionin e përbashkët për paqen dhe sigurinë botërore.

Të nderuar deputetë,

Vendimi për t'iu bashkuar ushtrisë amerikane në misionet paqeruajtëse ndërkombëtare është shprehje e përkushtimit të institucioneve të Kosovës për t'iu kontribuar paqes dhe sigurisë botërore. Prandaj, të nderuar deputetë, kërkoj nga ju që të miratoni vendimin e Qeverisë së Kosovës për të mundësuar realizimin e dërgimit të përbashkët të kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në kuadër të Gardës Kombëtare të Ajovës. Jam shumë mirënjohës për gatishmërinë tuaj për të qenë prezentë në këtë seancë që njëkohësisht tregon përkushtimin tuaj që përtej agjendave politike, të jemi të bashkuar në interesin për fuqizimin e shtetësisë së Kosovës në aspektin ndërkombëtar në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti ministër! Atëherë kryetarja e Komisionit Funkcional për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, zonja Fatmire Kollçaku, e ka fjalën për ta paraqitur dhe arsyetuar raportin e komisionit.

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit, kryetare!

Vetëm më vjen keq që duhet filluar me diçka, nëse diçka është e vërtetë, është që ne sonte nuk jemi model as për partnerët tanë dhe as për askënd, kur ia lejojmë vetes që jemi përshëndetur në një seancë që thamë se është e fundit, kur kemi bërë takimet e fundit të komisioneve dhe ne detyrohemi që një vendim kaq të rëndësishëm për vendin, për FSK-në, ta miratojmë në rrethana të këtilla, edhe pse dihet që mbështetja për FSK-në nuk do të mungojë nga asnjë grup parlamentar.

Ne si Komision për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes kemi punuar në mënyrë shumë unike, kemi sjellë vendime që në vazhdimësi të mbështesim, sidomos FSK-në, në të gjitha takimet dhe vizitat që i kemi pasur dhe të gjithëve sonte na ka ardhur keq në takimin e thirrur në orët e vona për një situatë të tillë, në të cilën na ka sjellë kjo qeveri. Para se të lexoj rekomandimin, dua të them që ngritja e aftësive të pjesëtarëve të FSK-së është më shumë rezultat i përpjekjeve dhe përkushtimit të vetë pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë, se sa mbështetja që ka bërë me fonde kjo qeveri. Jo vetëm shkurtime buxhetore që janë bërë për vitet e tjera, por edhe në rishikimin e buxhetit ka pasur shkurtime për FSK-në, e është pikëpyetje se si ka mundur të ndodhë kjo dhe të gjitha planifikimet buxhetore që ka bërë kjo qeveri janë në shpërputhje të plotë me planin gjithëpërfshirës të tranzicionit përkitazi me nevojën që ka Forca për buxhet.

Pra, këto shkurtime buxhetore, lirisht mund të themi, të bëra në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin dhe avancimin e FSK-së në arritjen e kapaciteteve të plota operationale. Me këtë buxhet që ka paraparë kjo qeveri për FSK-në nuk mund të zhvillohen dhe të avancojnë kapacitete të reja, përveç mirëmbajtjes të disa kapaciteteve të emergjencave, por kurrësi që të avancojë siç kërkon ligji dhe nevoja e vendit duke iu përgjigjur zhvillimeve rajonale mbi sigurinë dhe forcimin e shtimit të kapaciteteve të vendeve, në shpërputhje me zhvillimin e kapaciteteve luftarake të vendeve fqinje, siç është, për shembull, Serbia.

Shkurtime buxhetore që po i bëhen sot FSK-së nga Qeveria e tanishme do të ndikojnë, pra drejtpërdrejt në mosngritjen dhe mosavancimin e kapaciteteve, si dhe rekrutimit të ushtarëve të rinj, e deri te blerjet e ndryshme të armatimit dhe sistemeve të tjera mbrojtëse. Dështimet e kësaj qeverie në raport me FSK-në janë mospërkrahja, pra me fonde, buxhet të pamjaftueshëm për FSK-në dhe për ngritjen e kapaciteteve operationale, sipas misionit që ka, mosrealizimi i planit gjithëpërfshirës të tranzicionit për blerjen e pajisjeve dhe sistemeve ushtarake të planifikimeve, rekrutimin e pjesëtarëve sipas planit, mosrealizimin e planeve në trajtimin bilateral ndërmjet FSK-së dhe partnerëve dhe mungesë e një vizioni se si do të duhej të dukej FSK-ja në të ardhmen, e shumë e shumë dështime të tjera.

Vota “për” dërgim të pjesëtarëve të FSK-së në mision jashtë vendit është votë për t’i motivuar ata pjesëtarë në mënyrë që edhe ata të jenë pjesë e rrjedhave dhe proceseve të ushtarëve të

NATO-s. Tani do ta lexoj përfundimisht rekomandimin e komisionit, pra Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, në mbështetje të nenit 62.1 të Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 0155 të datës 31. 12. 2020, për dërgimin e kontingjentit të Forcës së Sigurisë jashtë vendit dhe lidhur me këtë i paraqet Kuvendit këtë:

R e k o m a n d i m

- Të miratohet propozimi i Qeverisë për dërgimin e kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit në mision, në ofrimin e mbështetjes për stabilitet rajonal dhe operacione paqeruajtëse në regjionin e Komandës Qendrore Amerikane “US Central Command”.

Pra, ky është rekomandim i komisionit dhe ju ftoj që ta votoni.

KRYETARJA: Faleminderit, zonja kryetare! Po vazhdojmë me deklarin në emër të grupeve parlamentare, jemi dakorduar në Kryesi që secili grup parlamentar ta ketë nga një folës. Po filloj me Grupin Parlamentar të Vetëvendosjes, zotin Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje do ta votojë ‘për’ propozimin e Qeverisë për dërgimin e kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit. Është jashtëzakonisht e rëndësishme si për FSK-në, e si për vendin, si për ushtrinë e Kosovës, që të dërgohen ushtarë në misione paqeruajtëse, e kjo përbën një moment të veçantë për ushtrinë tonë.

Pra, meqenëse për herë të parë po merret vendim që ata të dërgohen në mision paqeruajtës, ky është avancim dhe avancim serioz dhe për këtë duhet të jemi falënderues jashtëzakonisht shumë Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ushtrisë amerikane, që pjesëtarët e FSK-së do të mund të jenë krah për krah Gardës Kombëtare të shtetit të Ajovës.

Në anën tjetër, është tejet brengosës fakti që na vjen ky vendim të merret sot në momentet kur ne edhe po presim që të vijë një vendim i Gjykatës Kushtetuese, i deklaruar më parë që do të ketë shpërbërje të Kuvendit. Pra, çka do të kishte ndodhur sikur ky vendim i Gjykatës Kushtetuese të na vinte para Vitit të Ri? Atëherë, ne do të mbesnim pa e marrë këtë vendim, Parlamenti do të shpërbëhej dhe misioni për dërgim i FSK-së jashtë vendit në mision paqeruajtës do të dështonte.

Pra, një çështje kaq e rëndësishme, kaq strategjike për vendin tonë, për ushtrinë tonë, është vënë në një lloj kumari, në njëfarë lloj lotarie, që në moment të fundit është marrë vendim. Nuk e di a keni marrë ju vendim, nuk e di a jua kanë përkujtuar që duhet të merrni vendim të tillë, unë mendoj që është meritë e përfaqësuesve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës që edhe ky vendim sot po merret, mbase jua kanë përkujtuar ata, se po të mos jua kishin përkujtuar ata, nuk do të kishim marrë fare, e kishim harruar këtë punë.

Pra, që të vijë diçka kështu shpejt e shpejt, e kësaj rëndësie kaq të madhe është dëshpëruese, por ne do ta votojmë, edhe pse e dimë që këtu nuk kemi të bëjmë vetëm me dështim të Ministrisë së Mbrojtjes, kemi të bëjmë edhe me dështim të misionit diplomatik të letrave që pritej të vinin nga shtetet përkatëse. Është dashur të merremi më herët me këtë punë dhe të mos na ndodhë gjithçka në sekondat e fundit. Jemi, pra, me fat që Gjykata Kushtetuese ende s'e ka publikuar atë letrën që të merret ky vendim kaq i rëndësishëm për vendin tonë. Dhe, në anën tjetër, të mos i përmendim ato anët e tjera të shkurtimeve buxhetor që u përmend nga kryetarja e komisionit përkatës.

Pra, dështimet në transicion, nëse është planifikuar që FSK-ja të kthehet në ushtri në bazë të ligjit dhe është një proces që janë paraparë buxhet i ndarë për katër vjet me nga 100 milionë euro për vit, në mënyrë që të mund të avancojë një grimë drejt ushtrisë, tash ato plane janë rrënuar plotësisht dhe jemi në një situatë krejtësisht të re.

Por, unë nuk po vë, nuk jam i befasuar nga kjo, për shkak se këtë përgjumje, këtë ngadalësi, këtë e kemi vërejtur tash e shumë kohë dhe nuk është vetëm me këtë çështje, nuk është vetëm te çështja e ushtrisë, është edhe te shumë çështje të tjera. Ta zëmë, këtu e kemi zotin Avdullah Hoti. A e dini ju zoti Avdullah Hoti për një vendim të organizatës që lidhet me trashëgimin kulturore, "Europa Nostra"? A e dini çfarë vendimi kanë marrë ata? Ata i kanë përzgjedhur 12 lokacione të rrezikuara të trashëgimisë, janë nominuar 12, nga të cilat do të përzgjidhen 7, e ndër të cilat është edhe Manastiri i Deçanit, është mirë që Manastiri i Deçanit është aty, po a e dini pse është përzgjedhur? Është përzgjedhur sepse konsiderohet Kosova si vend ku ka terroristët të ISIS-it dhe që e kanë rrezikuar atë manastir.

Kallëzomëni, ju lutem, a keni reaguar që sa muaj është kjo punë, a ka ndonjë reagim nga Ministria? A duhet thënë ndoshta zëvendësministrit tuaj t'ju shkund pak prej gjumit, reagoni më shpejt, sepse shumë shpejt vendime të tilla mund të merren. Pra, ju lutem, zgjohuni pak, edhe pak ditë kanë mbetur, por edhe këto ditë zgjohuni, jo kështu t'ju zgjojë dikush, t'ju shkund dikush e të na sillni në sekondat e fundit vendime të tilla kaq të rëndësishme për vendin.

Pra, ne do ta votojmë, ne besojmë që ushtria e Kosovës ka pjesëtarë të përgatitur mirë si fizikisht, si moralisht që të shkojnë dhe të përballen me situata të rënda dhe të ruajnë paqen kudo në botë, pra t'i kontribuojnë paqes kudo në botë bashkë, krah për krah me aleatët tanë, të cilët na kanë ndihmuar në momentet më të vështira dhe për këtë arsye ne do ta votojmë me plot vullnet këtë kërkesë.

KRYETARJA: Po vazhdojmë me Grupin Parlamentar të LDK-së, zoti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

I nderuar kryeministër,

E nderuar kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pra, siç po e shihni, nganjëherë edhe kërkesat e ambasadorëve të një vendi të rëndësishëm qenkan të pranueshme për të gjithë. Pra, po më vjen mirë që janë të pranueshme kërkesat specifike dhe të drejtpërdrejta. Po ashtu, po më vjen keq që po dëgjoj edhe këtu atë mllefin e sharrës së ditës së fundit apo të thikave të para do ditëve. Ajo që ne duhet të shohim sot këtu, është se sot Ushtria e Republikës së Kosovës, me lejen e Kuvendit të Republikës së Kosovës shkon në një mision paqeruajtës me kërkesë të Komandës qendrore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Nuk është pak, është shumë, është shumë për një shtet të vogël si Kosova.

Pra, sot është një ditë e madhe për Kosovën, pas një viti të vështirë për të gjithë, sot Kuvendi i Republikës së Kosovës ka nderin të fillojë me këmbë të mbarë vitin e ri, duke autorizuar pjesëmarrjen e ushtrisë në misione paqeruajtëse në botë, në kuadër të ushtrisë amerikane, respektivisht në kuadër të Gardës Kombëtare të shtetit të Ajovës. Ky është një hap ndoshta i vogël për paqen në botë, por një hap i madh për Kosovën dhe rolin e saj si një shtet i barabartë në familjen e madhe të kombeve paqedashëse.

Ushtria e Kosovës, e cila u ngjiz në luftën çlirimtare për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, sot do të jetë një kontribuuese për paqen në botë, si aleate dhe partnere e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, shtet ky që kontribuoi për lirinë, pavarësinë e Kosovës dhe, në fund, për themelimin e ushtrisë së saj. Ushtria e Kosovës, e cila edhe me Kushtetutë është garant i paqes, sigurisë dhe lirisë sonë, nga sot do të kontribuojë që paqja të vendoset e të mirëmbahet kudo në botë. Pra, aleanca e Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Bashkimin Evropian dhe me NATO-n nuk është vetëm një aleancë ushtarake ose sigurie, para së gjithash është një aleancë ku bashkohen vlerat më fisnike të njerëzimit, me besimin në një të ardhme paqësore për globin, ku popujt dhe individët do të jetojnë të lirë nga represioni e varfëria.

Pra, sot Kosova me krenari do të fillojë një etapë të re në historinë e saj dhe unë në cilësinë e kryetarit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës kam nderin dhe privilegjin që t'i drejtohem këtij Kuvendi dhe popullit të Republikës që ne e përkrahim plotësisht, pa hezitim, pa dyshim, këtë aleancë të pathyeshme, të patjetërsueshme dhe të panegociueshme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me NATO-n dhe me botën demokratike. Faleminderit!

KRYETARJA: Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetare e Kuvendit!

I nderuar Kabinet qeveritar, s'po di si t'ju drejtohem, në detyrë, a pas detyrë, a... nga vetë fakti që na keni thirrur në këto orë të vona sot dhe pa asnjëfarë kuptimi.

Duke pasur parasysh që sot jemi mbledhur për të marrë një vendim historik, një vendim i cili është ëndërr e shumë brezave, të cilët kanë pritur me vite të tëra, të mos themi me shekuj, që të vijmë te kjo ditë, është fare e pakuptimtë dhe e papranueshme që të bëhet në këtë mënyrë, shkarazi nëpër terr, në këtë formë aspak të hijshme dhe aspak për t'u krenuar.

Vonesa e pakuptimtë e kësaj seance lë shumë për të dëshiruar, se politika i ka futur duart thellë edhe në Forcat e Sigurisë së Kosovës, duke pasur parasysh që ky vendim, ose kjo kërkesë ka ardhur nga Ambasada e Amerikës më 22 tetor të vitit 2019, ky vendim është dashur të jetë vendimi i parë i kësaj legjislature dhe unë shtroj pyetje sot në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, pse kjo vonesë? Pse u desh që një vendim kaq të rëndësishëm Qeveria e Republikës së Kosovës ta marrë natën e vitit të ri, kur e gjithë bota është në pushim? Pse u desh që një vendim i tillë t'i vijë Kuvendit të Republikës së Kosovës në mënyrë të përshpejtuar dhe brenda dy-tri orësh të kalohet edhe në komision, e tani edhe në Kuvend?

Kjo vonesë është si pasojë e neglizhencës dhe e mosnjohjes së rëndësisë së Forcave të Sigurisë së Kosovës dhe Ushtrisë së Kosovës. Djemtë dhe vajzat e Forcës së Sigurisë së Kosovës tani më krenarë se kurrë do të rreshtohen me krenari përkrah ushtarëve amerikanë për ta ruajtur paqen në botë, ashtu siç me krenari u rreshtuan vajzat dhe djemtë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në vitin 1999 për ta çliruar Republikën e Kosovës nga okupatori serb dhe për ta larguar njëherë e përgjithmonë pushtuesin serb nga Kosova.

Ky vendim sonte edhe një herë dëshmon që Ushtria Çlirimtare e Kosovës bëri luftë të drejtë e të pastër për vendin dhe për popullin e vet.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Tani një fjalë e urtë popullore thotë, "Më mirë vonë, se kurrë". Prandaj, edhe pse jemi të vonuar, unë them me bindje të plotë se është mirë që ky vendim po merret sot, edhe pse ky vendim ka mundur të merret edhe para shtatë vjetëve, saktësisht në vitin 2014, kur atëherë presidenti Hashim Thaçi propozoi ndryshimet kushtetuese për ta bërë FSK-në ushtri. E atëherë, me këmbëngulje të fortë, me kokëfortësi, ai propozim, vetëm pse erdhi nga Hashim Thaçi, u kundërshtua verbërisht nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe nga Vetëvendosja.

Partia Demokratike e Kosovës sot dhe gjithëherë e jep shembullin se gjithmonë do të jetë opozitë për pushtetin, por asnjëherë nuk do të jetë opozitë për shtetin. Dhe, unë sot dua t'i uroj të gjithë ata djem dhe vajza që me krenari e bartin uniformën e Ushtrisë së Kosovës, ashtu siç janë pasardhës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ne si grup parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës do ta votojmë këtë vendim dhe njëherësh është kënaqësi kur dëgjon kërcënimet e aleatëve tanë amerikanë në fillim të këtij viti,

që na kërcënonin me tërheqjen e trupave amerikane nga Kosova, tani ftojnë për bashkëpunim që të radhitemi përkrah tyre në ruajtjen e paqes.

Këto dy parti që unë i përmenda dhe kjo parti që sot e sjell në këto orë të vona këtë vendim, dëshmojnë më së miri që e rrezikuan edhe miqësinë tonë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, prandaj janë njerëz të padenjë për të qeverisur më tutje. Faleminderit!

KRYETARJA: Nga Grupi Parlamentar i AAK-së, fjalën e ka Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Po më duket se e kemi nisur mbarë si Parlament, pas një viti jo shumë të lumtur. Urime 2021-ta! Urime, Kosovë!

E thanë edhe kolegët e mi, pavarësisht dallimeve politike që mund t'i kemi, kjo është njëra prej ngjarjeve më të mira që e shënon të paktën në këtë Legjislaturë, sepse Ushtria jonë e Kosovës për herë të parë do të jetë krah ushtrisë më të fuqishme në botë, Ushtrisë Amerikane.

Kjo është edhe meritë e shumë brezave që kanë sakrifikuar për të ardhur deri te liria, e mira e dëshmorëve, e martirëve të Kosovës. Është meritë e Ibrahim Rugovës, është meritë e Adem Jasharit, është meritë e të gjithë atyre që kanë kontribuar për ta krijuar një strukturë të sigurisë, e cila do të jetë krah ushtrisë, e besoj shumë shpejt edhe si shtet, pjesë e NATO-s. Pra, sot me të drejtë mund ta ndiejmë veten krenarë që do ta japim besimin edhe si subjekt politik, si Aleancë, por jam i bindur edhe me angazhimin e oficerëve të lartë, oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve, sepse pikërisht janë ata që me ditë e net, në borë e në shi, i kryejnë detyrat e veta për të qenë një kuadër cilësor që të jetë përkrah këtyre ushtrive.

Pra, edhe një herë, i përgëzoj të gjithë aktorët që e kanë sjellë këtë situatë deri këtu dhe i falënderoj të gjithë ata që do ta japin sot besimin për këto marrëveshje. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Nisma-AKR-6+, fjalën e ka Endrit Shala.

ENDRIT SHALA: Faleminderit, e nderuara kryetare e Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër,

Ministër i Mbrojtjes,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar dhe shumë të respektuar qytetarë të Republikës së Kosovës, e më së shumti të nderuar ju të dashur ushtarë të Ushtrisë së Kosovës,

Si asnjëherë më parë në këtë foltore, sot unë jam duke u ndier jashtëzakonisht i emocionuar dhe njëkohësisht edhe shumë krenar, e siç besoj edhe të gjithë deputetët këtu të pranishëm.

Nuk do shumë mend që Ushtria e Kosovës është pika jonë më e dobët dhe njëherësh është krenaria më e madhe, për të cilën janë sakrifikuar gjenerata të tëra. Deri në fund me ata që arritën ta kthejnë në realitet ëndrrën tonë shekullore, e që është lufta çlirimtare apo e çlirimtarëve të UÇK-së. Nga kryengritjet e Isa Boletinit tek çetat e Shaban Polluzhës; nga lufta e Jasharajve, istikamet e Llapushës e të Dukagjinit, sot populli ynë krenar po e vazhdon rrugën në lartësim nëpërmjet aleancës me mikun tonë të përherëshëm Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Për secilin komb, në përgjithësi, e për ne si shqiptarë dhe si qytetarë të Republikës së Kosovës, në veçanti, Ushtria e përbën krijimin më të shtrenjtë dhe më sublim që kemi mundur ta arrijmë, e po e përsëris - e gjithë kjo e arritur falë luftës çlirimtare të UÇK-së. Aq më tepër për një komb si ne që krijimi i shtetit dhe i ushtrisë na mori aq shumë jetë, aq shumë vuajtje, aq shumë luftë e sakrificë në këto shumë vite. Ndër të tjera, sakrificë vazhdoi për ta mbrojtur pastërtinë dhe qëllimin e luftës sonë çlirimtare, që nga Fatmir Limaj e Ramush Haradinaj në Hagë, Sulejman Selimi e Sami Lushtaku, Rrustem Mustafa e Daut Haradinaj në Kosovë, e qindra ushtarë e gjeneralë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët me luftën e tyre dhe emblemën e Ushtrisë Çlirimtare arritën që populli ynë ta shijojë lirinë dhe shtetin e Kosovës. E këtë liri u desh ta sakrifikojnë që ta mbrojnë pastërtinë e saj edhe para tribunaleve ndërkombëtare, por edhe në institucionet tjera të krijuara në Republikën e Kosovës. Fatkeqësisht, kjo sakrificë nuk është duke u ndalur, sakrificë e këtyre ose e djemve të UÇK-së, me të njëjtin qëllim që ta mbrojnë pastërtinë, me qëllimin fisnik dhe qëllimin fisnik që e ka pasur lufta e UÇK-së për kombin tonë. Kjo luftë e cila pastaj kulmoi me krijimin e shtetit dhe të Ushtrisë së Kosovës.

Jakup Krasniqi tash, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi, Sali Mustafa, Nasim Haradinaj, Hysni Gucati, po përballen me padrejtësinë e njëjtë, siç janë përballur bashkëluftëtarët e tyre. Kundër të njëjtëve po tentohet dhe po tentohet me çdo kusht që ta tjetërsojnë qëllimin e luftës së tyre, qëllimin e pastër që e ka pasur lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Por, ashtu siç kemi arritur atëherë, do të arrijmë prapë. Ne e dimë të gjithë, kemi humbur shumë, shumë burra, shumë gra, të cilët e kanë dashur jashtëzakonisht shumë këtë tokë, e kanë dashur jashtëzakonisht shumë këtë ushtri, por ia kemi dalë. Ushtria tashmë është krijuar.

Nëse dikush do të më pyeste sot se cila është gjëja më e mirë, ose gjëja më të cilën krenohesh ti si qytetar i Republikës së Kosovës, si shqiptar, nuk do të mendohesha dy herë për të thënë se janë djemtë dhe vajzat e Kosovës që e bartin uniformën më të shtrenjtë në botë me emblemën dhe flamurin më të mirë në botë, flamurin e shtetit të Kosovës, të cilin do ta ruajnë dhe do ta mbrojnë përjetësisht - Flamuri ynë kombëtar shqiptar.

Pak muaj më parë, unë personalisht si deputet i kam uruar personalisht Arlena Shalën dhe Ylli Dalladakun, të cilët shënuan historinë, duke u bërë kosovarët e parë që diplomuan në Akademinë Ushtarake Prestigjioze të Uest Point në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Arlena dhe Ylli, që tashmë janë pjesë e Ushtrisë së Kosovës, dëshmuar se Kosova ka shumë për t'i dhënë botës. Aq

shumë, sa u mjafton vetëm një mundësi e vogël për të depërtuar atje ku lufta bëhet për paqe, atje ku luftohet për të sjellë paqe në rajon dhe në botë.

Një mundësi të tillë nuk e kurseu asnjëherë miku dhe aleati ynë i përhershëm, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Një mundësi të tillë veçse shumëfish më të rëndësishme Amerika tashmë po ia jep tërë misionit ushtarak të Kosovës, po ia jep Ushtrisë së Republikës së Kosovës. Marrja e vendimit të përbashkët për dërgimin e kontingjentit të Ushtrisë së Kosovës në misione jashtë vendit me Ushtrinë e SHBA-ve, respektivisht me Gardën Kombëtare të Ajoës, është hapi i parë i rëndësishëm për ta shpërndarë ushtrinë tonë nëpër botë.

Unë edhe si deputet, por edhe ne si Nismë si Grup Parlamentar Nisma-AKR-6+ nuk kemi asnjë dyshim më të vogël se ky është vetëm fillimi. E kemi për krenari të ju themi përderisa baballarët, vëllezërit dhe motrat e këtyre djemve dhe vajzave që sot e bartin uniformën e Ushtrisë së Kosovës, në atë kohë luftuan për lirinë e Kosovës. Këta të rinj tash, ushtarët dhe ushtaret e Republikës së Kosovës, e ndër ta po e përmend një emër që po më kujtohet tash, Kumanova, që është nipi i dëshmorit Sadik Shala dhe shumë e shumë nipa, djem e mbesa të ish-dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, tash e tutje do të luftojnë për paqe në botë dhe do të luftojnë nën komandën dhe me komandantët e shtetit mik të Kosovës, me komandën e Ushtrisë Amerikane.

Pasardhësit e tyre luftuan për një Kosovë të lirë, e këta nga nesër do të luftojnë për një botë më të mirë, për paqe kudo në botë. Ku ka krenari më të madhe se kjo? Ata më mirë se ne ndoshta e dinë rëndësinë e një misioni kaq të rëndësishëm dhe njëkohësisht aq shumë fisnik, siç është misioni për sjelljen e paqes kudo nëpër botë. Ne jemi të sigurt se secili ushtar që e bart uniformën e Republikës së Kosovës do të na bëjë edhe të gjithë neve këtu krenarë, do ta bëjë Kosovën krenare dhe do t'ua japë hakun atyre që dhanë jetën për këtë ushtri, ushtri e cila po nis rrugëtimin saj nëpër botë, rrugë kjo që e dimë e cila nuk do të ndalet asnjëherë, sepse ushtria jonë, ashtu sikur edhe Kosova, kanë prirje euroatlantike dhe janë përkrah miqve tanë, aleatëve tanë të përhershëm, e që janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Andaj, edhe një herë po e ripërsëris, ne si Grup Parlamentar Nisma-AKR-6+ e përkrahim këtë propozim të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe do të votojmë për dhe njëkohësisht në emër të grupit, i thërrasim ose u bëjmë kërkesë të gjithë ushtarëve dhe ushtareve të Republikës së Kosovës, shkoni dhe kthehuni faqebardhë.

Luftoni për lirinë dhe paqen në botë, kthehuni me fitore, garantojeni lirinë dhe paqen në botë, ashtu siç dini ju më së miri.

Të nderuar deputetë,
E nderuar kryetare e Kuvendit,
Kabinet qeveritar,

Në emër të grupit, më lejoni që edhe një herë nga zemra ta uroj sinqerisht secilin ushtar të Republikës së Kosovës, i cili nga sot, pas këtij vendimi të Parlamentit të Republikës së Kosovës, tashmë do të jetë pjesë e misioneve paqeruajtëse në botë. Ushtarët tanë do të dëshmojnë se Kosova ka shumëçka t'i japë botës dhe se ky është vetëm hapi i parë, por assesi i fundit për të garantuar paqe në botë dhe në rajon. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Meqenëse kemi dakordim që ta kemi nga një folës nga secili grup parlamentar, unë po e ftoj ministrin e Mbrojtjes që ta përmbyllë, meqë më herët e kërkoi fjalën, në qoftë se dëshironi.

MINISTRI ANTON QUNI: Faleminderit zonja kryetare për mundësinë që t'i falënderoj të gjithë aktorët që kontribuuan dhe po kontribuojnë që të ndërtojmë partneritet të fuqishëm me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të jemi në shërbim me ushtarët e FSK-së kudo që njerëzimi ka nevojë për ne.

Po mbes borxh edhe për disa shpjegime dhe sqarime që u ngritën nga deputetët, por mendoj se këto çështje u ngritën për shkak të mungesës së informatave, apo nëse janë të bazuar apo mbështetur në informata të gabuara në lidhje me buxhetin dhe shkurtime të buxhetore.

Të gjitha veprimet në këtë drejtim janë ndërmarrë në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mbrojtjes, gjithnjë duke e pasur parasysh, përkundër asaj që keni nevoja të mëdha. Po e marr një shembull, një mjet taktik i tipit Hummer, më i thjeshti, e ka vlerën 260 mijë euro dhe në momentin kur kompletohet me sisteme armatimi, ndërlidhje, komunikim, gps, navigim e tjera e të tjera, arrin vlerën deri në 360 mijë euro.

Ne i kishim dy mundësi, ta marrim një Hummer më shumë, apo ta shkyçim një pacient nga respiratorët, dhe natyrisht që kemi qenë për atë që ta shpëtojmë një jetë. Do të thotë, është bërë një kompromis. Por, duke e pasur parasysh partneritetin që e kemi me shtetet mike dhe duke e kuptuar situatën tonë, të gjitha këto mangësi në aspektin financiar kompensohen nga donatorët.

Pra, të gjitha ato objektiva që i kemi të parapara do të realizohen. Asgjë nuk lëndohet nga procesi, apo nga të gjitha ato fazat e tranzicionit të FSK-së deri në vitin 2028.

Në lidhje me vonesat, pse kjo seancë mbahet sot, e tjera e të tjera, nëse diku ndërtohen alternativat, ato ndërtohen në ushtri. Njëri opsion për një situatë të rëndomtë kur ekziston një stabilitet institucional, dhe është opsioni i dytë apo alternativa tjetër kur janë edhe situatat e tilla, kur Parlamenti është para shpërbërjes, por është edhe opsioni i tretë, edhe po të deklarohej tani Gjykata Kushtetuese që duhet të shpërbëhet Parlamenti dhe duhet të shkojmë në zgjedhje, edhe ky variant do të siguronte dërgimin e Forcave të Sigurisë së Kosovës krah për krah me Gardën e Ajrovës në misionet paqeruajtëse.

Do të thotë, ne jemi në të gjitha fazat e parapara, të parashikuara dhe të përgatitura mirë. Faleminderit dhe urime të gjithëve! Urime Kosovë!

KRYETARJA: I lus të gjithë deputetët që të kthehen në sallë. Përderisa po përgatitemi për këtë votim, që vërtet është i natyrës historike, por është edhe krenari e dyfishtë, sepse në radhë të parë është krenari për djemtë dhe vajzat e FSK-së që janë sot këtu si rezultat i përpjekjeve të brezave të tërë, por është krenari edhe për shkak se e gjithë kjo është e arritur së bashku me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Jam vërtet shumë e lumtur që si Kuvend i Kosovës po e përmbyllim këtë legjislaturë pikërisht me një vendim të tillë, dhe po ashtu jam e bindur që ky është vetëm fillimi për sukseset e FSK-së, sukseset e ushtrisë sonë. Po i presim deputetët që të kthehen në sallë.

Tani po e përsëris, meqenëse kishim dakordim të Kryesisë që të flasë nga një përfaqësues i grupeve parlamentare dhe po ashtu këtë e konfirmuam edhe më herët me grupet parlamentare, i lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për dërgimin e kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit me mision ofrimin e mbështetjes për stabilitet rajonal dhe operacione paqeruajtëse në regjionin e Komandës Qendrore Amerikane “US Central Command”.

I lus deputetët që t’i zënë vendet e tyre dhe që me ngritje dore të deklarohen për propozim-vendimin.

Kush është për? Faleminderit! A ka kundër? Nuk ka! Jemi në proces të votimit, ju lus! A ka abstenime?

Konstatoj se me 92 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, kontingjenti i Forcës së Sigurisë së Kosovës dërgohet jashtë vendit me mision ofrimin e mbështetjes për stabilitet rajonal dhe operacione paqeruajtëse në regjionin e Komandës Qendrore Amerikane.

Vendimi i dërgohet u. d. Presidente e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit final për dërgimin e kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në përmbyllje të kësaj seance, shpresoj kësaj radhe vërtet të fundit, që edhe në emër tuajin t’u uroj shërim të shpejtë të gjithë të lënduarve nga shpërthimi i tmerrshëm që ka ndodhur sot gjatë ditës në Ferizaj. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*